

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Për: **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**

Nr1 i prokurimit	207-25-936-1-1-1
Nr i brendshëm	207-25-008-1-1-1

Sa i përket tenderit për: **Furnizim [kornizë] me rekuizita dhe pajisje sportive për institucionet arsimore, programet institucionale dhe organizatat profesionale në Republikën e Kosovës [Ri-tenderim i dytë].**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Fatmir Godeni B.I.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Tirana p.n.

(Adresa)

Prizren

20 000

(Vendi)

(Kodi postar)

049 858 412

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Fatmir Godeni

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@sportingsks.com

(Adresa elektronike)

27.01.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Njoftimi për kontratë i datës 19.02.2025
2. Dosja e tenderit e datës 26.02.2025
3. B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 31.03.2025
4. B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 03.04.2025
5. B58 Njoftim mbi vendimin Rekuizita 17.06.2025.
6. B58 Njoftim mbi vendimin e AK-MKRS - Rivlerësimi 15.12.2025.
7. B58 Njoftim mbi vendimin e AK-MKRS - Rivlerësimi 15.01.2026.
8. Kërkesa për rishqyrtim e datës 19.01.2026.
9. Vendimi mbi refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim i datës 22.01.2026.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☒				Jo	☐	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Në rregull, sipas kohës së paraparë për hapjen e ofertave

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	☐				Jo	☐	
----	--------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

Neni 27 Dosja e Tenderit.

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit.

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të KRPP-se.

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.**

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

--

Te pa kënaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK** te datës 15.01.2026 ku na refuzohet kërkesa për rishqyrtim ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Furnizim [kornizë] me rekuizita dhe pajisje sportive për institucionet arsimore, programet institucionale dhe organizatat profesionale në Republikën e Kosovës [Ri-tenderim i dytë]** me nr. te prokurimit: **207-25-936-1-1-1** dhe me numër et brendshëm te prokurimit : **207-25-008-1-1-1** ne në afatin ligjor konform nenit 109 te LPP-së, e ushtrojmë këtë ankese pranë OSHP-se:

Për shkak se AK- **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK** :

1. Ne mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi qe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) te vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT.)
2. Ne mënyrë te kundërligjshme **ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit** pasi qe neve kemi ofertuar me tender te përgjegjshëm pasi qe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) te vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT.)

Sqarojmë ne mënyrë te detajuar :

Autoriteti Kontraktues – AK **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK** ne mënyrë te kundërligjshme **ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit** pasi qe neve kemi ofertuar me tender te përgjegjshëm dhe AK është dashur ta vazhdoj me këtë procedure duke përfunduar ne mënyrë te suksesshme dhe duke e publikuar njoftimin për dhënie te kontratës e jo njoftimin për anulim.

AK si arsye te anulimit e ka cekur si ne vijim:

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Ministria e Kultures Rinise dhe Sportit, Nëna Terezë nr. 35 – Prishtinë, pas aprovimit të buxhetit

Shpërblen me kontratë: **Asnjë Operator Ekonomik**

Kanë ofertuar pesë (5) OE me 5 oferta të ndryshme.

Data: 15.01.2026
Emri dhe mbiemri i ZPP: **Valbone Zekaj**

Zv. Drejtor i Zyrës së Prokurimit- MKRS

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Pra nuk e ka cekur asnjë arsye e anulimit te këtij aktiviteti te prokurimit e as ne baze te cilit nen te cilit ligj duhet kjo procedure te anulohet por çka eshte me se keqi qe e kan anuluar pas aprovimit te buxhetit si me sipër ne arsyetim dhe e kane cekur se :

Shpërblen me kontratë: Asnjë Operator Ekonomik

Kanë ofertuar pesë (5) OE me 5 oferta të ndryshme.

Pra sipas AK paska dashtë te ofertohet me oferta te njëjta aspo çfarë qëllimi ka qene kjo neve e kemi te paqartë. AK ne momentin qe e shpall një procedurë te prokurimit duhet ta dije mire se nuk ka kthim prapa, Zyrtaret e Prokurimit te secilit AK kryejnë rregullisht trajnime për LPP dhe duhet ta kenë te qarte se pas hapjes se ofertave, kur duhet te anulohet një procedure e prokurimit sipas LPP-se.

Si arsye e anulimit AK te eliminimit ne letrën standarde AK ka cekur se:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Pas vlerësimit të ofertës komisioni i vlerësimit ka konstatuar se **Fatmir Godeni B.I** nuk e ka plotësuar kërkesën **kërkesën** me nr.1.Pas vlerësimit të ofertës komisioni i vlerësimit ka konstatuar se Fatmir Godeni B.I nuk e ka plotësuar kërkesën kërkesën me nr.1.1 Kërkesa 1.1. - Operatori ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi te kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme në sektorin përkatës; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve të shkuara, ka zbatuar kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme] për furnizime me rekuizita dhe pajisje sportive [ngjashëm me ato të kërkuara në kornizë të kësaj lënde], në shumën e përgjithshme prej 1,000,000.00 € [Një milion euro]. Në listën e kontratave dhe referencave ngjashëm me ato të kërkuara në kornizë të kësaj lënde Operatori Ekonomik ka vetëm 647,374.70€ kontrata të ngjashme dhe si i tillë nuk e arrin të përmbush kriterin e AK.

OE ne fjale nuk i plotëson kriteret e kërkuara pasi qe Kontratat (ne listën e kontratave) me numër 70, 72, 73, 80, 81, 82, 83, 84 dhe 91 janë Renovime, intervenime jashtë kërkesës dhe kategorisë

se lejuar dhe kërkesës ne FDT dhe Njoftim për Kontratë, ne këtë formë Kontratat tjera nga 1 deri ne 70 janë me te vjetra se 3 vite ndërsa këto qe janë paraqitur janë Intervenime dhe jo furnizime sipas rekuizitave ne listën e paramases.

Pra AK ne NJK dhe DT ka vendosur kërkesën si ne vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1.1. - Operatori ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi te kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme në sektorin përkatës; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve të shkuara, ka zbatuar kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme] për furnizime me rekuizita dhe pajisje sportive [ngjashëm me ato të kërkuara në kornizë të kësaj lënde], në shumën e përgjithshme prej 1,000,000.00 € [Një milion euro].

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.1. - Operatori ekonomik, duhet të dorëzoj dokumentacionin si në vijim - ‘Kontratat dhe Raportet e pranimit të mallrave’, të lëshuara nga autoritetet kontraktuese, publike ose private, të cilat vërtetojnë kontraktimin dhe zbatimin e kontratave përkatëse -Një [1] kopje e origjinalit. OSE - ‘Certifikatat Referencat e përfundimit të kontratës’, të lëshuara nga autoritetet kontraktuese, publike ose private, të cilat vërtetojnë kontraktimin dhe zbatimin e kontratave përkatëse -

Një [1] kopje e origjinalit. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.2. - Për të gjitha ‘Kontratat dhe Raportet e pranimit të mallrave’ DHE OSE ‘Certifikatat Referencat e përfundimit të

kontratës' të deklaruar, Operatori ekonomik, duhet të plotësoj në tërësi Tabelën nr. 1 - Një [1] kopje e origjinalit.

pra neve AK na ka njoftë sipas tyre i kemi 647,374.70€ kontrata te vlefshme te ngjashme me këtë aktivitet te prokurimit tani lind pyetja se pse nuk është e vlefshme kontrata me numër 72 dhe 73 kur gati e tere kontrata ka qene furnizim me pajisje sportive te ngjashme te cilat jane edhe ne paramase te këtij aktiviteti te prokurimit ku vetëm edhe me këto dy kontrata po e tejkalojmë kresen e AK-se

72	Titulli:Ndertimi I kendeve te lodrave dhe fitnesit per Komunen e Prishtines	2021	2022	Kuvendi Komunes I Prishtines	237,509.00 €	616-21-4895-5-2-1
73	Titulli:Ndertimi I kendeve te lodrave dhe fitnesit LOT-1 DHE ndertimi I fushave sportive LOT-2	2022	2022	Kuvendi Komunes I Prishtines	278,036.47 €	622-22-10061-5-2-1

Pastaj kontrata me numër 80, 81, 82, 83, 84 ku AK i ka shique vetëm numrat e prokurimit por kontrata me numër 80 edhe numrin e prokurimti e ka furnizim pra njëjtë sikurse ky aktivitet i prokurimit pra kontratat e tjera disa e kane shërbime e disa e kane pune pasi qe janë te përziera pra Për kontratat e përziera që përfshijnë furnizime, shërbime dhe punë, **numri i prokurimit caktohet sipas komponentës me vlerën më të lartë financiare**, e cila konsiderohet objekti kryesor i kontratës njejte edhe ne këto raste AK-te e kane përcaktuar. Ku **Lloji i prokurimit (dhe rrjedhimisht numri i prokurimit)** përcaktohet nga: **furnizimi, shërbimi ose puna që përbën pjesën dominuese financiarisht të kontratës.**

80	Titulli:Inventarizimi I objekteve kulturore rinore e sportive Komunen e Prizrenit	2023	2023	Kuvendi Komunal I Prizrenit	112,768.00 €	622-23-1663-1-2-1
81	Titulli:Ndertimi I shtegut ne Tukbahqe	2023	2023	Kuvendi I Komunes se Prishtines	98,140.00 €	616-23-2670-5-2-1
82	Titulli:Zhvillimi I puneve ndertimore dhe furnizimit me mallra sportive profesionale per renovimin e salles se vogel te sporteve ne Pallatin e Rinis dhe Sportit ne Prishtine	2023	2023	Ministria e Kultures Rinis dhe Sportit	198,992.99 €	207-23-5335-5-2-1/C270
83	Titulli:Ndertimi dhe mirembajtja e pajisjeve te Fitnesit dhe kendit te lodrave ne kryeqytet	2023	2023	Kuvendi I Komunes se Prishtines	73,000.00 €	616-22-14042-2-2-1
84	Titulli:Rregullimi dhe Renovimi I Tereneve sportive ne Komunen e Prishtines	2023	2023	Kuvendi I Komunes se Prishtines	1,246.70 €	616-22-13229-5-2-1

Pra shihet qarte se AK na ka diskriminuar haptas ne këtë aktivitet te prokurimit pasi qe jo vetëm qe e kemi plotësuar kërkesën e AK-se por e kemi tejkaluar dyfish atë kërkesë.

Neve ja kemi bashkangjitur te gjitha kontratat dhe raportet e pranimeve teknike gjithashtu shume qarte shënon neper paramasa pasi qe jemi kompania e vetme ne Republikën e Kosovës qe merremi me këtë lloj te aktivitetit ku i kemi lokalet dhe jemi te vetmit qe e bëjmë furnizimin me pajisje sportive jo vetëm për institucione shtetërore por edhe persona tjerë juridik e privat ne tere territorin e Republikës se Kosovës dhe me një fjale jemi te vetmit te specializuar për këto lloj aktivitete ku me ndershmëri dhe profesionalizëm e kemi ngrit kompaninë tone ne nivelin te cilin jemi si Kompania me profesionale dhe me e besueshme ne vend për furnizim me te gjitha llojet e pajisjeve sportive.

Neve me kënaqësi ju ftojmë qe te vini për vizite ne lokalet tona dhe te bindeni edhe me shume me profesionalizmin tone edhe pse ju kemi ofruar dëshmi te mjaftueshme.

Ne baze te kontratave qe i kemi prezantuar e kemi dëshmuar se neve jemi te profesionalizaur për te gjitha llojet furnizimeve, shërbimeve dhe të punëve qe kane te bëjnë me pajisje sportive.

Gjithashtu edhe Gjate vlerësimit te stërzgatur AK i ka shkel te gjitha procedurat e prokurimit me këto veprime te kundërligjshme pra AK me datën 01.04.2025 i hap ofertat kurse gati pas një viti e publikon njoftimin për anulim ku kundërligjshëm i merr këto veprime pasi që dihet qarte se sipas rregullores konkretisht neni 40.3 thuhet:

Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nga komisioni vlerësues, dhe nxjerrja e Njoftimit mbi vendimin e AK nga ZPP, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Ndërsa AK –se ju ka dashtë kohe gati një vit për ta vlerësuar këtë aktivitet te prokurimit dhe ne fund duke e dështuar pra duke mos e finalizuar me njoftimin për dhënie por me anulim te kundërligjshëm.

Neve kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim me pretendimet e njëjta si me sipër dhe AK na kthen përgjigje te njëjtë se:

Refuzimi i pretendimit ankimor nga ana e Fatmir Godeni B.I.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik ankues lidhur me dëshmitë e përvojës profesionale, Autoriteti Kontraktues sqaron si në vijim: Referencat e paraqitura për projektet/kontratat me numër 72, 73, 81, 82 dhe 84, të cilat mbajnë numrin serik të prokurimit 5-2-1 (respektivisht: 616-21-4895-5-2-1 / 622-22-10061-5-2-1 / 616-23-2670-5-2-1 / 207-23-5335-5-2-1 dhe 616-22-13229-5-2-1), sipas Udhëzuesit për Prokurimin Publik dhe klasifikimit zyrtar të prokurimit, kategorizohen si punë (5) dhe jo si furnizime (1). Si të tilla, këto kontrata konsiderohen investime kapitale dhe nuk mund të pranohen si dëshmi e vlefshme për përmbushjen e kërkesës për furnizime të ngjashme / furnizim me rekuizita, ashtu siç është përcaktuar qartë në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit. Autoriteti Kontraktues ka analizuar në mënyrë të detajuar paramasat, përshkrimin e aktiviteteve dhe ndarjen financiare të këtyre kontratave, dhe ka konstatuar se ndarja ndërmjet komponentës së punëve dhe furnizimeve nuk arrin të plotësojë kriterin e referencës së kërkuar, pasi komponenta dominuese financiare dhe funksionale e këtyre kontratave është e natyrës së punëve, e jo e furnizimeve. Për rrjedhojë, referencat në fjalë nuk janë pranuar si të vlefshme për përmbushjen e kriterit të përvojës profesionale, pasi nuk janë në përputhje me kërkesat specifike të Autoritetit Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit. Autoriteti Kontraktues thekson se vlerësimi është kryer në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, Udhëzuesit përkatës dhe parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë. Si rezultat, oferta e Operatorit Ekonomik ankues nuk ka arritur të përmbushë kërkesën për dëshmi të furnizimeve të ngjashme, dhe për këtë arsye është paraqitur si Operator Ekonomik i eliminuar. **Dhe duke i paraqitur arsyetimet e theksuara me lartë Operatori Ekonomik Fatmir Godeni B.I. nuk e plotëson komponenten financiare të kërkuar në FDT dhe Njoftimin për Kontratë B05 / Referenca të natyrës së ngjashme në vlerë financiare prej 1,000,000.00 Euro.**

Pra AK as që e ka marrë mundin ti shikoj pozicionet e këtyre kontratave. Pra AK duhet ta dije se nuk ka kërkuar kontrata të njëjta por të ngjashme, të ngjashme janë të gjitha kontratat pasi që të gjitha kontratat tona janë pajisje sportive pasi që neve merremi vetëm me furnizim të pajisjeve sportive e jo me lëmi tjera. Limitet e shprehjes “të ngjashme” janë shumë të pa caktuara. AK nuk ka kërkuar kontrata të njëjta.

Gjithashtu AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së ku në pikën 1 thuhet se : *Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Ndërsa në pikën 2 thuhet :

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Gjithashtu AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së ku thuhet:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Tenderi jonë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

AK për këtë aktivitet të prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë **tenderi i përgjegjshëm** me **Çmimin më të ulët**.

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit dhe kemi ofertuar me **tenderin e përgjegjshëm** me **Çmimin më të ulët**.

Me anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit AK ka bërë shkelje të nenit 62 të LPP-së pasi që asnjë pikë e këtij nenin nuk plotësohet në këtë rast që po e përshkruajmë komplet nenin e Ligjit si ne vijim:

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:
 - 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.
2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:
 - 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo
 - 2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Gjithashtu Neni 43.5 i Rregullores përcakton pikat në të cilat, në këtë rast konkret, **asnjë nga këto kushte nuk qëndron**, nëse i lexojmë me kujdes arsyet e anulimit të një aktiviteti të prokurimit sipas rregullores asnjëra prej tyre nuk qëndrojnë për arsye se:

- a. *asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar; janë paraqitur më shumë se një tender brenda afatit të specifikuar;*
- b. *asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; tenderi jone është i përgjegjshëm;*
- c. *numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre); (kjo pikë nuk është për këtë procedurë pasi që procedura është kontratë publike kornizë me një operator ekonomik)*
- d. *nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociatë, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; (kjo pikë nuk është për këtë procedurë pasi që ky aktivitet ka qenë me procedurë të hapur)*
- e. *numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociatë është më pak se 3; (kjo pikë nuk është për këtë procedurë pasi që ky aktivitet ka qenë me procedurë të hapur)*

f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; (kjo pike nuk është për këtë procedure por është për procedura te konkurseve te projektimit)

g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm; (kjo pike nuk është për këtë procedure por është për procedura te konkurseve te projektimit)

h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; nuk ka asnjë urdhër nga OSHP për anulim

i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; Kurrfar shkelje te asnjë neni te asnjë ligji nuk ka ndodhur nuk është cekur ne B58 asnjë shkelje nuk është cekur asnjë nen i asnjë ligji dmth edhe kjo pike nuk vlen.

j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose

k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP". As këto opsione nuk kane ndodhur sepse AK para hapjes se ofertave disa herë ka bere ndryshime.

Anulimi i procedurës është bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me **nenin 43.5 të Rregullores për Prokurim Publik**, duke keqpërdorur diskrecionin dhe duke tejkaluar kompetencat që i njeh ligji Autoritetit Kontraktues.

Neve si operator ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit jemi palë me interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, pasi që në çdo mënyrë kemi dëshmuar se këto shkelje te AK-se na shkaktojë dëme te drejtpërdrejta pasi qe ne këto rrethana dhe fakte është dashur qe neve te shpallemi fitues i këtij tenderi. Anulimi, në këtë rast, është përdorur si mjet për të shmangur përfundimin e procesit dhe për të anashkaluar ofertën tonë konkurruese sa i përket Operatoreve qe kane ofertuar me çmime me te lira se neve atëherë ju sqarojmë se botërisht dihet qe asnjëra prej tyre nuk e kanë profesion llojin e këtij aktiviteti te prokurimit por i kanë profesion shtypshkronjat pra nuk kem çka te shtojmë me tepër por ky aktivitet nuk është shtypja e librave por furnizim me pajisje sportive ku jemi te vetmit te specializuar ne këtë lëmi.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga OSHP e ta detyroj AK-në qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi dhe ti respektoj kërkesat e veta qe vet i ka vendosur ne NJK dhe DT lidhur ne këtë aktivitet te prokurimit dhe te nxjerr:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik : **Fatmir Godeni B.I.** Lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizim [kornizë] me rekuizita dhe pajisje sportive për institucionet arsimore, programet institucionale dhe organizatat profesionale në Republikën e Kosovës [Ri-tenderim i dytë]** me nr. te

prokurimit: 616-24-11988-2-1-1 dhe me numër te brendshëm: 616-24-230-2-1-1 te inicuar nga AK-
MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.

II. ANULOHET njoftimi për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim [kornizë] me rekuizita dhe pajisje sportive për institucionet arsimore, programet institucionale dhe organizatat profesionale në Republikën e Kosovës [Ri-tenderim i dytë] me nr. te prokurimit: 616-24-11988-2-1-1 dhe me numër te brendshëm: 616-24-230-2-1-1 te inicuar nga AK- **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK** dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim** Dhe te Urdhërohet AK që pas rivlerësimit te na shpërblej me kontrate pasi qe kemi ofertuar konform nenit 60 te LPP-se me **tenderin e përgjegjshëm** me **Çmimin më te ulët**.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke anuluar kundërligjshëm këtë aktivitet te prokurimit, gjë që ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta materiale, përfshirë:

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionit mbështetës bashke me sigurimet e tenderi;
- Mbajtja ne pritje e mjeteve dhe e punëtorëve.
- Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundshme;
- Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet.
- Depozita për parashtrim te ankesës dhe mbajtja e parave te bllokuara duke mos i vendosur ne qarkullim na shkakton dem te drejtpërdrejtë neve si kompani.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*